

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Për realizmin e pagesave dhe shërbimeve financiare përmes aplikacionit Swinto

Kjo Kontratë për realizmin e pagesave dhe shërbimeve financiare përmes aplikacionit Swinto (tutje referuar si “Kontrata”) lidhet në mes të Tregtarit dhe Swinto Sh.A me numër unik identifikues 811448720 dhe me adresë në Rruga Anton Çetta, Nr.5A, Prishtinë, Kosovë (tutje referuar si “Swinto”). Kjo Kontratë paraqet termet dhe kushtet e përgjithshme për realizmin e pagesave dhe shërbimeve financiare përmes aplikacionit Swinto te Tregtarët.

Definicionet

Tregtari - një klient i Swinto i cili shet mallra apo ofron shërbime dhe përdorë një ose më shumë shërbime të mbledhjes së pagesave përmes aplikacionit Swinto të Swinto.

Blerësi - një pagues dhe/ose një marrës përfundimtar i shërbimeve të ofruara dhe mallrave të shitura nga tregtari duke përdorur aplikacionin Swinto për realizimin e pagesave.

Projekti - një përshkrim i hollësishëm i mallrave dhe/ose shërbimeve të ofruara nga tregtari me qëllim të mbledhjes së pagesave nga blerësit për mallra ose shërbime të ofruara nga tregtari me mjetet e treguara në sistem.

Instrument i pagesave elektronike (IPE) – është instrumenti që i mundëson mbajtësit të kryej pagesa elektronike. Këtu përfshihen si instrumentet e pagesave me qasje në distancë, ashtu edhe instrumentet e parasë elektronike;

Aplikacioni Swinto – Aplikacioni, përmes të cilit tregtari pranon pagesën për mallrat e shitura apo shërbimet e ofruara dhe blerësi kryen pagesat për mallrat e blera apo shërbimet e pranura.

Para elektronike - është vlera monetare e regjistruar në formë elektronike ose magnetike, e cila lëshohet me pranimin e fondeve për qëllime të kryerjes së transaksioneve të pagesës dhe që përfaqëson një detyrim të lëshuesit të parasë elektronike ndaj pranuesit të saj, i cili është një person fizik ose juridik, i ndryshëm nga lëshuesi i parasë elektronike;

Pagesë elektronike – është transaksioni i pagesës, i realizuar nëpërmjet një karteje që përmban një shirit magnetik, një mikro qark (chip) ose një kod identifikues dhe që përdoret në një terminal të pagesave elektronike, në një terminal pikë shitje (POS) etj. apo nëpërmjet një aplikacioni duke përdorur mjete elektronike të komunikimit;

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1. Swinto i ofron Tregtarit shërbimin e mbledhjes së pagesave nga blerësit duke përdorur aplikacionin Swinto/llogarinë e Swinto apo kartelave për pagesa.
2. Mënyrat se si do të bëhet mbledhja e pagesave nga ana e tregtarit për në llogarinë e tij do të zgjidhet nga tregtari gjatë paraqitjes së procesit. Swinto dhe Tregtari sigurojnë që të dhënat i mbledhin dhe përpunoj bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrotjen e të dhënave personale dhe GDPR.
3. Me qëllim të funksionalizimit të këtij shërbimit, Tregtari do të dorëzoj te Swinto të gjitha dokumentet e nevojshme.
4. Ofrimi i shërbimit të mbledhjes së pagesave përmes aplikacionit Swinto për tregtarin do të konfirmohet nga ana e Swinto, vetëm pas përfundimit të integritit të sistemit sipas udhëzimit të dorëzuar nga ana e Swinto.
5. Pas sigurimit të këtij shërbimi Swinto i ofron Blerësve pagesa përmes aplikacionit Swinto te Tregtari. Tregtari në këtë drejtim duhet që të angazhohet që të instaloj dhe të përdorë njëren nga mënyrat e mbledhjes së pagesave përmes llogarisë në Swinto.
6. Tregtari mund të kërkoj të shtoj edhe shërbimin “mbledhja e pagesave përmes internetit përmes

- kartelave të pagesave”. Për ofrimin e shërbimit të pagesave përmes kartelave të pagesave, Swinto dhe Tregtari do të nënshkruajnë marrëveshje me shkrim paraprakisht, e cila do të jetë aneks i kësaj kontrate.
7. Tregtari i cili është person juridik, deklaron se personi i autorizuar nga tregtari, ka të gjitha autorizimet për të rënë dakord me të gjitha kushtet e kësaj kontrate, ka të drejtën dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për të kërkuar shërbime në emër të personit juridik. Tregtari sipas kërkesës do të dorëzojë te Swinto të gjitha dokumentet për të siguruar që kompetencat e deklaruara janë të vërteta.

Neni 2

Tarifat dhe procedurat e pagesës.

1. Tregtari pajtohet dhe garanton që është i informuar në detaje në lidhje me çmimet dhe kushtet e mbledhjes së pagesave përfshirë por duke mos u kufizuar në transferimet e pagesave dhe të gjitha shërbimet e Swinto të cilat aplikohen sipas kësaj kontrate dhe ofrohen nga Swinto, konkretisht sipas çmimeve për transaksione të ofraura te Tregtari.
2. Tregtari garanton që nuk do të zbatojë asnjë tarifë shtesë në rastet kur blerësit përdorin sistemin e Swinto për pagesë. Tregtari po ashtu garanton që nuk do të vendosë kufizime shtesë që mund të diskriminojnë blerësit, si dhe metodat e ofruara të pagesës përmes aplikacionit swinto të Swinto.
3. Swinto pranon shumën e të hyrave të treguara në urdhrin e pagesës nga blerësi dhe në mënyrë automatike e informon sistemin e informacionit të tregtarit për transaksionin e përfunduar. Sistemi gjithashtu do të informojë blerësit për urdhërat në pritje. Tregtari mund të vendosë që të refuzojë këtë funksion.
4. Në rastet kur tregtari ofron shërbime apo shet mallëra të ndryshme pa e pranuar pagesën tregtari operon nën rrezikun e tij dhe Swinto nuk do të mbahet përgjegjës.
5. Me paraqitjen e një kërkesë nga tregtari dhe pas pëlqimit nga Swinto, tregtari mund të zgjedh që të gjitha të hyrat e kredituara tek ai, të konvertohen në një monedhë sipas kërkesës së tregtarit.
6. Sipas kërkesës së Tregtarit, Tregtari dhe Swinto mund të arrijnë marrëveshje për të përdorur të hyrat apo një pjesë të të hyrave të pranuar nga tregtari për shërbimin e ofruar, për të paguar shpërblime ndaj blerësit. Një marrëveshje e tillë duhet të konfirmohet me shkrim nga dy palët kontraktuese.
7. Tregtari garanton që blerësi i cili përdorë aplikacionin Swinto të Swinto për kryerjen e pagesave, nuk do të ngarkohet me shumë nga sistemi për blerjen e mallërave apo pranimin e shërbimeve nga tregtari.
8. Swinto obligohet për ruajtjen së kopjeve të urdhërpagesave në periudhë kohore jo më të shkurtë apo më të gjatë nga ajo që përcaktohet sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Rimbursimet

1. Nëse një shumë e caktuar është pranuar gabimisht në favor të tregtarit, atëherë, Tregtari mund të kërkojë nga Swinto që të ja kthen Blerësit shumën e plotë apo të pjesëshme. Kërkesa duhet dërguar përmes sistemit. Rimbursimi kryhet në të njëjtën mënyrë siç është kryer pagesa (rimbursimi në para të gatshme nuk ofrohet). Tarifa e komisionit e bërë gjatë pranimit të pagesës nuk i kthehet tregtarit. Para kërkesës për rimbursim, përmes sistemit do të bëhet njoftimi për tarifën e komisionit për shërbimin e ofruar.
2. Tregtari dhe Swinto nuk do të jenë përgjegjës apo të bartin rrezikun për dëmin që shkaktohet nga pagesat e paautorizuara përmes sistemeve të treta.
3. Tregtari dhe Swinto dakordohen që Tregtari mund të mbajë një rezervë fondesh të mjaftueshme, e cila do të mbahet në llogarinë e Swinto, për të siguruar kërkesat e pagesave në rast të mosmarrëveshjeve apo ndryshimeve tjera thelbësore në modelin e biznesit të partnerit.
4. Në rast të ndryshimit të shumës dhe kohëzgjatjes së rezervës palët do të nënshkruajnë një marrëveshje të veçantë.
- 5.

Neni 4

Integrimi teknik i shërbimeve

1. Me fillimin e përdorimit të mbledhjes së pagesave sipas kësaj kontrate, nga ana e Tregtarit, ai angazhohet që të bëjë lidhjen e sistemit të tij me atë të Swinto dhe të njëjtën kohë të bëjë instalimin e programve të nevojshme, për të cilat Swinto jep udhëzimet direkte.
2. Tregtari informohet dhe e kupton që integrimi i pasaktë i sistemit mund të shkaktoj ngarkesa brenda sistemit, të cilat janë të padëshirueshme dhe të papranueshme. Në këtë drejtim, Tregtari garanton që lidhja e sistemeve do të bëhet në mënyrë rigoroze duke respektuar udhëzimin e Swinto.
3. Swinto rezervon të drejtën që në çdo kohë dhe pa asnjë kufizim të bëjë ndryshime në zgjidhjen dhe integrimin teknik të shërbimeve. Për çdo ndryshim i cili ka nevojë për rregullim brenda sistemit apo programit, Tregtari do të njoftohet të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë më herët. Të njëjtën kohë, Swinto do t'i përcjell udhëzimet mbi sistemin e ri dhe do të bëjë aranzhimin dhe lidhjen e sistemeve brenda 90 ditëve nda dita e njoftimit. Në rast se ka kërkesa për ndryshime nga ana e Tregtarit, shpenzimet për këto ndryshime do të kryhen nga ana e Tregtarit, ndërsa shpenzimet për ndryshimet që vijnë nga kërkesat e Swinto do të mbulohen nga Swinto.

Neni 5

Konfirmimet dhe Marrëveshjet e Palëve

1. Tregtari merr përsipër të informojë dhe promovoj tek blerësit se pagesat mund të kryhen përmes aplikacionit Swinto të Swinto.
2. Palët mund të arrijnë marrëveshje për marketing të përbashkët. Marrëveshja për marketing të përbashkët përcakton qëllimin e bashkëpunimit, kanalet e komunikimit, kostot e kampanjës, dhe menyrën e kalkulimit dhe ndarjen e kësaj kosto.
3. Tregtari dhe Swinto e kanë të ndaluar të përdorin llogot dhe shenjat tjera identifikuese të njëra tjetrës për qëllime të pa përcaktuara me këtë kontratë.
4. Swinto dhe Tregtari marrin përsipër të ndjekin ndryshimet në llogot, emrin ose informacionin tjetër të Tregtarit dhe Swinto dhe të përditësojnë të dhëna të tilla në uebfaqet e tyre brenda 1 (një) muaji pasi të aplikohen ndryshimet e tilla ose në rastet specifike sipas kërkesës së palës që ka bërë ndryshimet në të dhënat e veta.
5. Tregtari garanton që ai i mbanë të gjitha të drejtat e pronësisë në raport me mallin të cilin e shet apo të shërbimeve që i ofron, dhe garanton që sistemi nuk do të përdoret nga personat e tretë të cilët nuk janë të autorizuar nga tregtari për të përdorur sistemin.
6. Tregtari siguron që të gjitha veprimet e tregtarit në lidhje me ekzekutimin e Kontratës, si dhe mallrat e shitura apo shërbimet e ofruara do të jenë në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe të shtetit në vendin ku mallrat shiten dhe shërbimet ofrohen. Tregtari mbanë përgjegjësi për të gjitha pasojat që mund të lindin si pasojë e mosrepektimit të ligjeve.
7. Swinto nuk do të mbahet përgjegjëse për mallrat e shitura dhe/ose shërbimet e ofruara nga tregtari dhe pasojat që vijnë nga shitja e mallrave dhe/ose ofrimi i shërbimeve.
8. Tregtari dhe Swinto marrin përsipër të sigurojnë zbatimin e duhur të mjeteve për kryerjen e transaksionit dhe mjetet tjera teknike të destinuara për mbrojtjen e të dhënave personale të blerësve nga shkatërrimi aksidental ose joligjor, zëvendësimi, zbulimi ose përpunimi tjetër i jashtëligjshëm siç përcaktohet me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
9. Të dhënat personale të blerësve, si pages, mbledhen dhe përpunohen sipas kërkesave të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren e Përgjithshme të BE për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).
10. Tregtari dhe Swinto sigurojnë mbrojtjen e të dhënave të identifikimit të mjeteve të pagesave të blerësve dhe të dhënave të tyre personale, si dhe garantojnë që të dhënat e tilla nuk do të bëhen të njohura për asnjë palë të tretë, përfshirë edhe punonjësit e tregtarit.

11. Swinto dhe Tregtari, duke ofruar përkatësisht përdorur shërbimet për nevoja biznesi, rekomandohet të përdorin "Etiketë të Cilësisë dhe Besueshmërisë" në uebfaqen e tyre.
12. Tregtari pajtohet që llogoja e tij dhe përshkrimet e shërbimeve dhe/ose mallrave të shfaqen në Sistemin e Swinto.
13. Institucionet financiare janë të obliguara sipas legjislacionit në fuqi të njohin klientët e tyre përshfirë pronarët e kompanive për klientët biznesor. Për përmbushjen e këtij obligimi Tregtari merr përsipër të informojë Swinto për çdo ndryshim, përfshirë informacionin në lidhje çdo ndryshim në kompani duke përfshirë por mos u kufizuar në: ndryshimin e udhëheqjes, pronarëve, drejtorëve, llojin e veprimtarisë, personat e autorizuar me të drejtën e nënshkrimit, adresën e Internetit dhe informacione të tjera, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në ekzekutimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune para ndryshimeve të tilla. Tregtari merr përgjegjësi për të gjitha pasojat që lindin në rast të mos-ekzekutimit të detyrimeve dhe mosnjoftimi në kohë të caktuar.
14. Swinto dhe Tregtari do të informojnë njëra – tjetrën menjëherë për çdo rrethanë, e cila ka ndikuar të shkaktohet dëmtimi i sistemeve të informacionit ose ekzekutimi i Kontratës, gjithashtu japin informacione të tjera që mund të jenë të nevojshme për ekzekutimin e duhur të Kontratës.

Neni 6
Detyrimet e Tregtarit
Standardet për mbrojtjen e mbajtësit të instrumentit të pagesave elektronike

Në kuadër të mbrojtjes së mbajtësit të shfrytëzuesve të aplikacionit Swinto, tregtari:

1. Mund t'i kërkojë mbajtësit paraqitjen e një dokumenti të identifikimit, në rast dyshimi për identitetin e tij, përpara pranimit të një pagese me IPE;
2. Duhet të refuzojë pranimin e një pagese në rastet e mëposhtme:
 - 2.1 Pavlefshmërisë së IPE-së;
 - 2.2 Njofimit për vjedhje apo humbje të IPE-së;
 - 2.3 Mospërputhjes së nënshkrimit të autorizuar në IPE me nënshkrimin e dokumentit të transaksionit apo mjetit të identifikimit;
 - 2.4 Refuzimit nga ana e mbajtësit për të treguar një dokument identifikimi ose nëse tregtari identifikon që një person i paautorizuar përdor IPE-në;
 - 2.5 Pamundësisë së marrjes së konfirmimit për kryerjen e transaksionit;
 - 2.6 mungesës ose pasaktësisë së të paktën një elementi sigurie të IPE-së;
 - 2.7 Dyshimeve për një falsifikim/kopjim të IPE-së;
 - 2.8 Mungesës së nënshkrimit të autorizuar në IPE, nëse kjo është e domosdoshme për efekt vlefshmërie;
3. Mund të mbajë IPE, në rastet e mëposhtme:
 - 3.1 Lajmërimin për vjedhje apo humbje të IPE
 - 3.2 Mospërputhjes së nënshkrimit në IPE me nënshkrimin e faturës së blerjes;
 - 3.3 Përdorimit të IPE nga një person i paautorizuar;
 - 3.4 Marrjes së një urdhri nga pranuesi për mbajtjen e IPE; dhe
 - 3.5 Konstatimit se të paktën një nga elementet e sigurisë nuk është i saktë.
4. Duhet të kujdeset për procedurat e sigurisë, gjatë kryerjes së transaksioneve dhe të mos bëjë publike të dhënat personale dhe/ose numrin e kartelës së mbajtësit, personave të paautorizuar si dhe të mos lejojë përdorim të gabuar/pasaktë apo falsifikim/kopjim të IPE;
5. Duhet të pranojë pagesat e kryera nëpërmjet IPE-së, brenda kushteve dhe termave të njëjta si për pagesat në para të gatshme dhe nuk duhet të aplikojë ndaj mbajtësit komision apo tarifa shtesë, mbi çmimin e pagesave të kryera nëpërmjet tyre.

Neni 7

Detyrimet e Swinto me instrumentet e pagesave elektronike

Swinto, për pranimin e pagesave me IPE, duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Të hapë llogari pagese në emër të biznesit apo tregtarit;
2. Të bëjë të mundur pranimin dhe kryerjen e transaksioneve me IPE;
3. Të regjistrojë çdo transaksion dhe të ruajë regjistrimet për një periudhë kohore të mjaftueshme, në mënyrë që të mundësohet identifikimi i transaksioneve të realizuara dhe ndreqja e gabimeve në rastet e përcaktuara në kontratë;
4. Të zbatojë procedurat e sigurisë për garantimin e kryerjes së transaksioneve me IPE;
5. Të zbatojë aktet juridike për ruajtjen e të dhënave dhe të sekretit bankar; dhe
6. Të njoftojë me shkrim tregtarin për propozimet e ndryshimeve të dispozitave të kontratës.

Neni 8

Aktivite të ndaluara

1. Për të gjitha aktivitetet e ndaluara me legjislacionin në fuqi në Kosovë apo aktivitetet e ndaluara me akte ndërkombëtare, Swinto ka të drejten për mos hapje, pezullimin apo mbylljen e llogarisë.
2. Tregtari deklaron, se të gjitha shërbimet dhe mallrat të cilat i ofron në shitje nuk shkelin dispozita ligjore të legjislacionit të aplikueshëm në vendin ku ofrohen këto shërbime. Të njëjtën kohë ka të gjitha licencat e nevojshme për kryerjen e atij aktiviteti.

Neni 9

Pezullimi i Shërbimeve

1. Në rast se tregtari nuk është në gjendje ose nuk do të jetë në gjendje t'i ofrojë shërbime blerësit (p.sh. është i falimentuar), Swinto gëzon të drejtën e pezullimit të shërbimit të mbledhjes së pagesave apo përfundimin e kontratës. Kjo klauzolë nuk zbatohet në rast se tregtari i paraqet blerësit dokumente që konfirmojnë aftësinë e tregtarit për të ofruar shërbime ndaj blerësit.
2. Swinto duke vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe konform legjislacionit në fuqi ka të drejtë të bëjë kufizimin e ofrimit të një pjese apo të gjitha shërbimeve pa ndonjë njoftim paraprak, pezullimin e ndonjë pagese të mbledhur, të ndërpresë Kontratën, apo të pezulloj shërbimin e ofruar në këtë kontratë/apo rezervën, pezullimin e ndonjë pagese të tregtarit, apo të ndërpresë Kontratën dhe mos të e ofroj këtë shërbim nëse Swinto vihet në dijeni se:
 - 2.1 Tregtari bën shkelje të dispozitave ligjore të dhe angazhohet në aktivitete të cilat janë të ndaluara;
 - 2.2 Shërbimet e ofruara apo mallrat e shitura dëmtojnë reputacionin dhe biznesin e Swinto;
 - 2.3 Tregtari nuk i përmbush detyrimet të cilat i ka për obligim si pjesë e kësaj kontrate ose ka mundësi që këto detyrime nuk do të përmbushen me ç'rast interesi i blerësit mund të dëmtohet.
 - 2.4 Nëse tregtari bënë mbledhjen e pagesave përmes adresave të internetit (URL), të cilat janë të shënuara në projektin e tregtarit por nuk janë të konfirmuar nga Swinto.
 - 2.5 Me shkelje eventuale në të gjitha rastet e tjera të cilat janë të përcaktuara në marrëveshjen e shërbimit të pagesave.
3. Swinto do të informojë tregtarin për kufizimin e ofrimit të shërbimeve dhe mundësinë e kthimit të fondeve, brenda 2 (dy) ditë pune nga pezullimi i ofrimit të shërbimeve.
4. Në mënyrë që klientët - tregtari dhe blerësit të mbrohen nga mashtrimi në internet, Swinto gjithmonë do të vlerësojë në mënyrë objektive dhe të shpejtë situatën aktuale të tregtarit dhe blerësit dhe pas marrjes së deklaratave nga dy palët do të marrë masat e duhura të sigurisë për mbrojtjen e tyre.
5. Qëllimi i kufizimeve të përcaktuara në këtë Kontratë është të mbrojë Swinto, Klientët -Tregtarin dhe blerësit dhe personat e tjerë të tretë nga sanksionet e mundshme monetare, humbjet dhe pasojat e tjera negative.

Neni 10

Informimi për problemet teknike

Për të gjitha dështimet teknike të cilat mund të jenë të njohura, të mundshme apo për shkak të paisjeve të palëve të treta, Swinto do të e njoftoj Tregtarin paraprakisht në rast se do të ketë ndikim në kualitetin e shërbimeve. Të njëjtën kohë, Tregtari merr për obligim që të njoftoj Blerësin dhe Swinto, për të gjitha dështimet teknike, apo punimet e planifikuara që do të bënin parandalimin apo riparimin e programit apo paisjes të cilat do të kenë ndikim në ofrimin e shërbimeve apo shitjen e mallrave nga tregtari.

Neni 11

Mosmarrëveshjet midis Tregtarëve dhe Blerësve

1. Swinto, nuk përfshihet dhe nuk do të hetoj mosmarrëveshjet mes tregtarit dhe blerësit. Swinto ofron vetëm shërbimin e pagesave.
2. Blerësit dhe Tregtari mund të ju drejtohen gjykatës ose institucioneve tjera kompetente përmbrojtjen e të drejtave të shkelura.
3. Në lidhje me ankesat për çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e realizimit të pagesave/transaksioneve apo çështjeve të tjera në lidhje me aplikacionin Swinto, Swinto Sh.A. do të trajtoj ankesat bazuar në legjislacionin në fuqi përfshirë rregulloren e BQK për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave. Mënyra e paraqitjes së ankesave është e përcaktuar me kontratën për hapjen e llogarisë së pagesave nga personat fizik dhe juridik.

Neni 12

Konfidencialiteti

1. Swinto dhe Tregtari pajtohen se të gjitha informacionet konfidenciale që shkëmbejnë në mes veti, dokumentet dhe çdo informacion i mundshëm i shkruar në formë elektronike, i dërguar në formë fizike apo i komunikuar përmes mjeteve të komunikimit si telefonat etj, do të mbetet konfidencial dhe nuk do të ndahet me palët e treta.
2. Parimi i konfidencialitetit nuk vlen në rastet kur:
 - 2.1 Është e nevojshme përmbushja e detyrimit ligjor;
 - 2.2 Ka urdhër të lëshuar nga Gjykata për dorëzimin e dokumentacioneve;
 - 2.3 Paraqitet kërkesë e institucionin kompetent për tatime, vlerësime apo regjistrime të tjera.
3. Informacioni Konfidencial” përfshin çdo informacion, të dhëna elektronike, teknologjinë e aplikuar (përfshirë teknologjia e aplikuar për shërbimet e pagesave) nga Shpalosësi ose fakte që nuk janë të publikuara ose të njohura për publikun, me karakter teknik, biznesor ose njohuri ose të drejta të tjera të pronësisë intelektuale, të dhëna, dokumente, të dhëna personale të ndonjë pale ose informacion tjetër që ka të bëjë me klientët e ndonjë Pale, punonjësit e saj, informacionin e brendshëm si dhe të gjitha informacionet e tjera të shpalosuar në çfarëdo forme gjatë diskutimeve dhe/ose negociatave.
4. Në rast të shkeljes së Konfidencialitetit nga cilado palë pjesë e kësaj kontrate, pala që ka bërë shkeljen do të bart të gjitha përgjegjësit dhe dëmet eventuale që mund të jenë shkaktuar palës tjetër.

Neni 13

Forca Madhore

1. Forca Madhore do të thotë çdo veprim, ngjarje ose kusht përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale që nuk ishte e parashikueshme në mënyrë të arsyeshme në kohën e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk mund të shmanget në rrethana normale, përfshirë, por pa u kufizuar në akte të Zotit, luftë, trazira, aktet e qeverisë, zjarret, përmytjet, shpërthimet e katastrofave të tjera etj.
2. Asnjë Palë nuk do të jetë përgjegjëse për çdo dështim për të kryer ose ndonjë vonesë në kryerjen e

ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate nëse dështimi ose vonesa e tillë vie si rezultat i Forcës Madhore. Pala që përballet me një ngjarje të Forcës Madhore do të njoftojë menjëherë Palën tjetër brenda 5 ditë pune nga paraqitja e rrethanave të tilla dhe do të përdorë përpjekjet e saj të arsyeshme për të korrigjuar çdo vonesë të shkaktuar menjëherë pas pushimit të zbatimit të një ngjarjeje të tillë.

3. Në rast të mos përbushjes së kësaj Marrëveshjeje ose nëse përbushja e dispozitave thelbësore të kësaj Marrëveshjeje ndikohet nga Forca Madhore, Palët do të përpiqen të përshtatin Marrëveshjen me situatën e re. Në rast se Palët nuk bien dakord për një adaptim të tillë, kontrata mund të ndërprehet sipas afateve të nenit 12.2 të kësaj kontrate.

Neni 14

Kohëzgjatja dhe Përfundimi i Kontratës

1. Kontrata ndërmjet Tregtarit dhe Swinto është kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Swinto dhe Tregtari mund të ndërpresin Kontratën, pas dhënies me shkrim të njoftimit për ndërprerje të Kontratës, me njoftim paraprakisht prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.
3. Në rast se Tregtari është i përfshirë në aktivitetet e kundërligjshme të cilat janë të parapara me legjislacionin në fuqi, Swinto pa njoftim paraprak do ta pezulloj llogarinë apo do ta mbyll atë sipas kërkesës nga autoritetet kompetente.

Neni 15

Dispozitat përfundimtare

1. Tregtari dhe Swinto konfirmojnë se i posedojnë të gjitha lejet dhe licencat e kërkuara në bazë të legjislacionit në fuqi që janë të nevojshme për ekzekutimin e kësaj Kontrate.
2. Tregtari dhe Swinto kanë përgjegjësi të pavarur ndaj shtetit dhe subjekteve të tjera për përbushjen e të gjitha detyrimeve tatimore. Swinto nuk do të jetë përgjegjëse për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të Klientit, llogaritjen ose transferimin e taksave të aplikuara për Tregtarin.
3. Swinto në të gjitha rastet vepron si një palë e pavarur e Kontratës dhe si e tillë nuk do të kontrollojë ose të marr përsipër përgjegjësi për produktet dhe shërbimet që paguhen për përdorimin e shërbimeve.
4. Swinto dhe Tregtari mund të transferojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre për palët e treta në çdo kohë me njoftim paraprak të njëri-tjetrit, nëse një transferim i tillë i të drejtave dhe detyrimeve nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
5. Kjo Kontratë është pranuar nga Swinto dhe Tregtarit në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën e kuptojnë dhe si e tillë Kontrata është e zbatueshme për të gjitha komunikimet e mëtejshme.
6. Anekset, Lidhjet në faqet e internetit të dhëna në Kontratë që rregullojnë ofrimin e shërbimeve të ndara janë një pjesë integrale e kësaj Kontrate dhe zbatohen për klientin që nga momenti kur fillojnë të përdorin shërbimin përkatës.
7. Palët kontraktuese në rast të mosmarrëveshjeve do të tentojnë që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me mirëkuptim, nëse kjo nuk është e mundur palët pajtohen se ligji i aplikueshëm është legjislacioni në fuqi në Kosovë dhe se gjykata kompetente në territorin e Prishtinës është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të palëve.
8. Përfaqësuesit e palët kontraktuese kanë dëshmuar identitetin e tyre si në hyrje të kësaj kontrate, kanë vërtetuar zotësinë e plotë për të vepruar, kanë dokumentuar se kanë autorizimet për përfaqësim dhe deklarohen se e kanë lexuar dhe kuptuar kontratën në tërësi, kontrata paraqetë shprehje të plotë të vullnetit të tyre dhe e nënshkruajnë pa vërejtje.